




FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

Marrëveshja për Inicimin e Projektit

Preambula

KJO MARRËVESHJE PËR INICIM TË PROJEKTIT (në tekstin e mëtejme "MIP") nënshkruhet në mes të:

Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (në tekstin e mëtejme "FKEE") me adresë Rr. Luan Haradinaj (ish Banka e Lubjanës), 10000 Prishtinë e përfaqësuar nga Admir Shala, Drejtor Menaxhues (në tekstin e mëtejme "FKEE")

Dhe

Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme "Përfituesi"), si palë në këtë Marrëveshje (në tekstin e mëtejme "Palët")

Neni 1.

Lënda e marrëveshjes

Subjekti i kësaj marrëveshje përcakton përgjegjësitë dhe qëllimet e ndërsjella të palëve përpara se të hyjnë në Marrëveshjen e Shërbimit të Energjisë (në tekstin e mëtejme MShE) për zbatimin e një Projekti Komunal të Eficiencës së Energjisë për t'iu nënshtruar Masave të Eficiencës së Energjisë në kuadër të projektit të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (Marrëveshja e Grantit, Financimi Shtesë – Eficienca e Energjisë dhe Projekti i Energjisë së Ripërtrijëshme ndërmjet Republikë së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) duke vepruar si administrator i Komisionit Evropian (Programi i Partneritetit i Bankës Botërore Pjesa III për Evropën dhe Azinë Qendrore Programi Fondi i Donatorëve të Mirëbesimit).

Neni 2.
Të drejtat dhe detyrimet e palëve

PALËT JANË PAJTUAR si vijon:

1. FKEE si një entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm i krijuar me Ligjin Nr. 06 / L-079 për Eficiencën e Energjisë, duke zbatuar Projektin Komunal të Eficiencës së Energjisë në përputhje me Doracakun Operacional të FKEE (në tekstin e mëtejshëm “DOiF”).
2. Përfituesi është person juridik që ka aplikuar pranë Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë për përkrahje financiare për implementimin e Masave për Eficiencë të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm “MEE”) në Projektin Komunal të Eficiencës së Energjisë (në tekstin e mëtejshëm “PKEE”), i implementuar nga FKEE dhe për të cilin FKEE konstaton se është i pranueshëm sipas kriterëve të përcaktuara në Thirrjen Publike të publikuar në 20.04.2020.
3. Përfituesi e pranon FKEE-në si ofruesin e kualifikuar të shërbimeve profesionale që do të rezultojnë në Kursim (kosto) të Energjisë dhe Buxhetit, si dhe për t’i përmirësuar nivelet e komoditetit dhe standardet e jetesës për përdoruesit e objekteve komunale dhe shërbimet e të cilit mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: analizën e përdorimit të energjisë (auditimin e energjisë), skemat e detajuara dhe specifikimet teknike për masat e eficiencës së energjisë, përfshirë këtu sistemet dhe pajisjet që duhet të instalohen dhe të mirëmbahen, punimet në ndërtim, mbikëqyrjen e implementimit, trajnimin bazë të punonjësve përfitues dhe monitorimin e PKEE siç parashikohet këtu dhe komisionimin e shërbimeve.
4. Palët bien dakord që ta iniciojnë implementimin e PKEE të Përfituesit ShFMU “FEHMI AGANI” me seli në adresën Rruga Ymer Pula, 50000 Gjakovë, në Republikën e Kosovës.
5. Palët janë të zotuar që t’i ndjekin dispozitat e DOiF, e cila është pjesë përbërëse e kësaj MIP, gjatë fillimit dhe përgatitjes së PKEE.
6. Duke pranuar këtë MIP, Përfituesi konfirmon se jep pëlqimin FKEE-së që të veprojë si *Agjent implementues* në emër të tij dhe të angazhohet në bazë konkurruese me kompanitë për të ofruar shërbime profesionale për (I) Auditimin e Energjisë, (II) Dizajnin, Mbikëqyrjen dhe Komisionimin dhe (III) Furnizimin e Punimeve, përfshirë pajisjet dhe materialet e nevojshme.
7. Palët janë zotuar që ta nënshkruajnë një Marrëveshje të veçantë të Shërbimit të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm “MSHe”) pas përzgjedhjes së Kontraktuesit për furnizimin e punimeve. Përfituesi në përputhje me metodologjinë e kalkulimit të projektuar të Kursimeve të (Kostos) Energjisë dhe krijimin e Skemës së Kompensimit të Investimeve në përputhje me Skemën e paraqitur në Nenin 7 të MSHe, do ta kompensojë FKEE për kostot e investimeve të PKEE.
8. Kostoja e shërbimeve tjera të ofruara nga FKEE, përfshirë menaxhimin financiar, prokurimin dhe mbikëqyrjen teknike do të kompensohen njësoj dhe në përputhje me termat dhe kushtet për tarifat dhe ngarkesat siç përcaktohen në paragrafin 1.6 B të MSHe standarde.
9. Përfituesi siguron qasje për FKEE, stafin e tij dhe përfaqësuesit, përfshirë kontraktuesit e FKEE, në lokacionin e PKEE të parashikuar të Përfituesit.
10. Përfituesi mban përgjegjësi për marrjen në kohë të të gjitha lejeve dhe aprovimeve dhe sigurimin e kushteve teknike të nevojshme për zbatimin e PKEE.
11. Nëse Përfituesi nuk i përmbushë detyrimet e marra nën këtë MIP ose i kryen ato vetëm pjesërisht ose refuzon të nënshkruajë MSHe brenda afatit të përcaktuar nga FKEE, MIP shkëputet me kërkesën e FKEE. Përfituesi e mbulon koston e shërbimeve, punimeve dhe/ose pajisjeve që i janë ngarkuar FKEE për zhvillimin e projektit (p.sh. auditimi i energjisë, dizajni etj.) deri në datën e përfundimit të kësaj MIP, brenda afatit të përcaktuar nga FKEE dhe Rregulloret e saj të Brendshme.
12. Në rast të mosekzekutimit ose mos përmbushjes së pjesshme të përgjegjësisë të shkaktuara nga ndonjë ngjarje e forcës madhore, Palët lirohen nga detyrimet. Forca madhore është definuar me nenin 6 të MSHe.

Neni 3.
Efektiviteti i MIP

1. Marrëdhëniet midis Palëve rregullohen nga kjo MIP deri në nënshkrimin e MShE-së. Efektiviteti i kësaj MIP përfundon me nënshkrimin e MShE.
2. Kjo MIP i nënshtrohet performancës së detyrueshme nga Palët.

Neni 4.
Ligjet e aplikueshme

1. Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga kjo MIP, e cila nuk mund të zgjidhet miqësisht ndërmjet Palëve, zgjidhet me ligjet e Republikës së Kosovës.
2. Çdo ndryshim i dispozitave nën këtë MIP bëhet me marrëveshje të ndërsjellë të Palëve duke e nënshkruar plotësim/ndryshimin e kësaj MIP.
3. Për qëllimet e koordinimit ditor të aktiviteteve të lidhura me projektin, secila Palë emëron përfaqësuesin e vet të autorizuar si një pikë të vetme kontakti për komunikim midis Palëve.
4. MIP është nënshkruar në Gjakovë, në dy (2) kopje në gjuhën shqipe dhe dy kopje (2) në gjuhën angleze; nga një (1) kopje për FKEE dhe një (1) kopje për Përfituesin.

Në emër të FKEE	Në emër të Përfituesit
Admir Shala Drejtor Menaxhues 	Ardian Gjini Kryetar  

Datë 01.09.2020

Gjakovë, Republika e Kosovës